

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi në lëndën penale kundër të akuzuarit M.N. nga fsh..... K.Ferizaj, për shkak të veprës penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 te KPK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr. 1063/2009 të datës 01.10.2009, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prani të prokurorit të shtetit Agim Kuka , të akuzuarit me 09.08.2016, shpall dhe publikisht komunikon, ndërsa përpilimi me shkrim i këtij aktgjykimi u bë më datë 01.09.2016 ku mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari :

M.N. data e lindjes.... ne fsh. e, nga i ati F. dhe e ëma M. e gjinisë D., i martuar, babë i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes se mesme ekonomike, punëtor në botën e jashtme, shqiptar, shtetas i Kosovës.

ESHTE FAJTOR

Sepse me dt. 01.07.2009, në intervalin kohor të papërcaktuar në fsh. Neredime e Epërme të Ferizajt, i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka pushtuar pronën e paluajtshme të Z.J. në atë mënyrë që në paluajtshmërinë e e cila evidentohet në Drejtorinë e Gjeodezisë, Pronës dhe Kadastrit KK Ferizaj, sipas certifikatës UL-72217022-00055 në vendin e quajtur FSHAT në sip. prej 864 m dhe 211 m e ka bërë rrethojën e paluajtshmërisë me tela gjembor pa pëlqimin e saj,

me të cilën ka kryer veprën penale pushtimi i paligjshëm i pronës se paluajtshme nga neni 259 par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar ne dispozitat ligjore te neneve 3, 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 75, 76 te KPRK-se dhe nenit 359 e 365 te KPPRK-se

GJYKON

Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 /dyqind / € të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajnë shumën me nga 30 /tridhjetë/€ në afat prej 30 ditësh.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP.nr.1063/2009 të datës 01.10.2009, ka akuzuar **M.N.**, për veprën penale pushtimi i paligjshëm i pronës se paluajtshme nga neni 259 par. 1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me datën 09.08.2016 në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit Agim Kuka, deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale,

duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptohet dënim i paraparë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 09.08.2016, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke shprehur pendim real për veprën e kryer.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale *pushtimi i paligjshëm i pronës se paluajtshme nga neni par 259 par.1 te KPK-së,*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është i evidentuar si kryes i veprave penale, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, si dhe në shqyrtimin gjyqësor, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar me gjobë, do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzet e pesë /€ në afat prej 30 ditësh

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr. 2042/12 me datë 01.09.2016

Bashkëpunëtorja profesionale

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

Gjyqtarja Individuale,

Hakile ILAZI

Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh. Kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.